



Në bazë të nenit 11 dhe 12.2 shkronja c), nenit 17 shkronja f) dhe p) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", 28/2008), dispozitave të Ligjit nr.05/L-087 për Kundërvajtje dhe nenit 8 paragrafi a) dhe b), neni 15 paragrafi 6) të Statutit të Komunës së Deçanit, nr. 01.Nr.IX-5 të datës 31.10.2019, Me rekomandim të Ministrisë së Drejtësisë, Kuvendi i Komunës së Deçanit ka Ri-shqyrtuar Rregulloren për Shërbimet Publike Komunale të miratuar me datën 31.03.2022, dhe për të njëjtën në mbledhjen e datës 29.12.2022, miraton këtë:

V E N D I M

MBI APROVIMIN E RREGULLORES PËR SHËRBIMET PUBLIKE KOMUNALE (SIPAS REKOMANDIMIT TË MINISTRISË SË DREJTËSISË)

Neni 1

Me këtë Vendim aprohet Rregullorja për Shërbimet Publike Komunale (sipas rekomandimit të Ministrisë së Drejtësisë), me të cilën propozohet që neni 157 i Rregullore të fshihet në tërësi, për arsye se nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe të zëvendësohet me një dispozitë të re, me tekstin "**Shqiptimi i sanksioneve kundërvajtëse bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi për kundërvajtjet**".

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti me emërtimin, Rregullore për Shërbimet Publike Komunale.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen Drejtoritë përkatëse të Komunës së Deçanit.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet: Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Drejtorive përkatëse të Komunës së Deçanit dhe Arhivit.

01.Nr.XV-8/1
Deçan,dt.29.12.2022

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, sipas neneve 4, 6 dhe 7, të Ligjit Nr.08/L-071 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturinat, nenit 26 paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.29.12.2022, bie këtë:

V E N D I M

PËR VËNIEN NË DISKUTIM PUBLIK TË PLANIT PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE 2023-2027

I.

Miratohet Vendimi për vënien në Diskutim të Planit për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027 në territorin e Komunës së Deçanit.

II.

Vënia në Diskutim Publik e Planit për Menaxhimin e Mbeturinave 2023-2027 në territorin e Komunës së Deçanit, bëhet me qëllimin e dhënies së kontributit nga Institucionet, ekspertët e fushës përkatëse dhe qytetarët, në mënyrë që i njëjti të jetë sa më funksional për subjektet implementuese dhe të tjerët.

III.


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit, si dhe publikimit në ueb faqen e Komunës.

IV.

Vendimi bëhet transparent përmes Tabelës së shpalljeve dhe Zyrës për Informim të Komunës së Deçanit.

01.Nr.XV-3

Deçan, dt. 29.12.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (d) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, sipas nenit 9 të Ligjit Nr.05/L-081 Për Energjinë, nenit 26 paragrafi 1, të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5 të dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.29.12.2022, bie këtë:

V E N D I M

PËR VËNIEN NË DISKUTIM PUBLIK TË DRAFT- PLANIT TË VEPRIMIT KOMUNAL PËR ENERIGJINË DHE KLIMËN (PVKEK) 2023 – 2030

I.

Miratohet Vendimi për vënien në Diskutim të Draft- Planit të Veprimit Komunal për Energjinë dhe Klimën (PVKEK) 2023 – 2030, për territorin e Komunës së Deçanit.

II.

Vënia në Diskutim Publik e Draft- Planit të Veprimit Komunal për Energjinë dhe Klimën (PVKEK) 2023 – 2030, për territorin e Komunës së Deçanit, bëhet me qëllimin e dhënies së kontributit nga Institucionet, ekspertët e fushës përkatëse dhe qytetarët, në mënyrë që i njëjti të jetë sa më funksional për subjektet implementuese dhe të tjerët.

III.


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit, si dhe publikimit në ueb faqen e Komunës.

IV.

Vendimi bëhet transparent përmes Tabelës së shpalljeve dhe Zyrës për Informim të Komunës së Deçanit.

01.Nr.XV-4

Deçan, dt.29.12.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



Në bazë të kërkesës së Drejtorisë për Shërbime Publike të Komunës së Deçanit, të dt.15.11.2022, për caktimin e lokacionit për Deponi inerte, Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave për vitin 2018-2022 si dhe Rregullores Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave me nr.të protokollit 4036 të dt.07.02.2019, si dhe Memorandumit të Bashkëpunimit në mes Komunës së Deçanit dhe GIZ-it i nënshkruar në Mars të vitit 2018, sipas nenit 23 paragrafi 2, nën paragrafi 5, të Ligjit Nr.08/L-071 Për Ndryshimin Dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-060 për Mbeturinat, bazuar në nenin 11, nenin 12 paragrafi 12.2 shkronja (d) nenin 17 shkronja f) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, dhe nenin 26 pika 7 të Statutit të Komunës së Deçanit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.29.12.2022, bie këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR DEPONI INERTE

I.

Caktohet lokacioni për Deponi inerte (mbeturina të ngurta) në funksion të gjithë qytetarëve të Komunës së Deçanit, në Njësinë kadastrale nr.P-70505078-00062-0, Zona Kadastrale Hulaj, e evidentuar si P.SH.OPPB (KOSOVODRVO PRISHTINA OOUR), dhe në Njësinë kadastrale nr.P-70505021-00353-0, Zona Kadastrale Deçan, e evidentuar si P.SH.O.TH.P.B.KOSOVODRVO PRISHTIN O.P.GJERAVICA.

II.

Implementimin e këtij Vendimi do ta bëjnë: Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër e Komunës së Deçanit.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Me Vendim njoftohen: Drejtoria për Shërbime Publike, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Arhivi i Komunës së Deçanit.

01.Nr.XV-6

Deçan, dt.29.12.2022

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT	
As. Thomunule	2350
01	23.01.23



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



Duke u bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2 shkronja (i) të Ligjit për vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, sipas neni 26 pika 6 të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, të datës 31.10.2019, bazuar në Ligjin për Sistemin e Adresave, Nr.04/L-071 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr.29/ 27 Dhjetor 2011), Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.14/2019 për Caktimin e Emërimit dhe numërimit të adresave për zona të qarkullimit publik, ndërtesa, shtëpi, objekte dhe parcela kadastrale të lira, me kërkesën e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës të dt.25.07.2022, nr.3967-2/22, për Rishqyrtim të Ligjshmërisë së Aktit, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.29.12.2022, nxjerrë këtë:

VENDIM

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT 01.NR.X-8 PËR EMËRIMIN DHE RI-EMËRIMIN E RRUGËVE NË KOMUNËN E DEÇANIT

I

Me këtë Vendim SHFUQIZOHET Vendimi I Kuvendit 01.Nr.X-8 për emërimin dhe ri-emërimin e rrugëve në territorin e Komunës së Deçanit, sipas të dhënave të prezantuara në vijim:

1. Në fshatin Carrabreg i Epërm, rruga e pa emëruar deri me tani, me gjatësi mbi 500 m, emërohet me emërin e veteranit të UÇK-së "Xhavit Dobraj".
2. Në qytetin e Deçanit, rruga e re e cila gjendet në mes të shkollës "Lidhja e Prizrenit" dhe QKMF "Adem Ukëhaxhaj" në Deçan, me gjatësi mbi 500 m, emërohet me emrin e Dëshmorit të Kombit "Halil Sejfiqaj".
3. Në fshatin Maznik rruga ekzistuese me emrin "Azem Sylaj", me gjatësi mbi 650 m. Riemërohet dhe zëvendësohet me emrin e rapsodit të ndjerë "Kushtrim Sylaj".
4. Në fshatin Prejlep rruga ekzistuese me emrin "Beteja", me gjatësi mbi 250 m. Riemërohet dhe zëvendësohet me emrin "Kreshnik Qufaj".

II.


Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në web faqen e Komunës.

III.

Vendimi u dërgohet: Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Ministrisë për Punë të Brendshme, Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Drejtorive Komunale, Zyrës për informim, Kryetarit të Komunës dhe Arkivit të Komunës.

01.Nr.XV-8/2

Deçan, dt.29.12.2022



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

[Handwritten signature]